



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 06 - P - 101, të datës: 13 maj 2019, miraton Opinionin e ndikimit buxhetor dhe Opinionin Ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për Nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-094, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës.
2. Vendimi bashkë me tekstin e opinioneve nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Task Forcës Kundër Narkotik tek të rinjtë dhe siguri në Shkolla

1. Themelohet Task Forca Kundër Narkotik tek të rinjtë dhe siguri në Shkolla me këtë përbërje :
 - 1.1. Shefi i Task Forcës emërohet z. Avdullah Hasani dhe nga një anëtar nga;
 - 1.2. Ministria e Punëve të Brendshme;
 - 1.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 1.4. Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.6. Ministria e Drejtësisë;
 - 1.7. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 1.8. Ministria e Administratës Publike;
 - 1.9. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.
2. Miratohet dokumenti i funksionimit të Task Forcës Anti Narkotik tek të rinjtë me mandat pesë vjeçar 2019-2024.
3. Mënyra e funksionimit, organizimit, aktivitetet dhe obligimet e Task Forcës Anti Narkotik janë të specifikuar në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Mandati i Task Forcës dhe shefit të saj është pesë vjeçar.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës (GZ Nr. 30, 15 qershor 2008), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. 24 Qershori caktohet Ditë Memoriale e komunitetit egjiptian të Kosovës.
2. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncepti dokumenti për Persona të Zhdukur.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Anullohet Vendimi i Qeverisë me Nr. 05/105, i datës 28.05.2019.
2. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe njoftohet Gazeta Zyrtare për publikim.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore N.P.H. Ibër Lepenc Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Bashkim Shabani, kryesues;
 - 1.2. Naim Gashi;
 - 1.3. Halil Gashi;
 - 1.4. Avdullah Isufi;
 - 1.5. Sahit Svirca;
 - 1.6. Muharrem Xhemajli.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Halit Isufi, kryesues;
 - 1.2. Hysen Fazliu;
 - 1.3. Rushan Ceka;
 - 1.4. Zelfije Pllana;
 - 1.5. Nuhi Provoliu;
 - 1.6. Ylber Zabergja.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Prishtina Sh. A. Prishtinë emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Betim Berisha, kryesues;
 - 1.2. Amir Gashi;
 - 1.3. Bajram Jashari;
 - 1.4. Albetron Sahiti;
 - 1.5. Sejdë Tolaj;
 - 1.6. Ilir Rexhepi.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për drejtorë në Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidrodrini Sh. A. Pejë, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Demë Abazi, kryesues;
 - 1.2. Valon Haxhiaj;
 - 1.3. Vllaznim Përgjegjaj;
 - 1.4. Naim Tahiri;
 - 1.5. Musë Mushkolaj;
 - 1.6. Nimon Zeneli.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 10/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për drejtorë në Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujitjes Drini i Bardhë Sh. A. Pejë, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Galdim Krasniqi, kryesues;
 - 1.2. Sali Sutaj;
 - 1.3. Gezim Dervishaj;
 - 1.4. Beqë Hadërgjonaj;
 - 1.5. Ali Nimanaj;
 - 1.6. Sylë Krasniqi.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovica Sh. A. Mitrovicë emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Faton Zekaj, kryesues;
 - 1.2. Sadri Konjuhi;
 - 1.3. Genc Mani;
 - 1.4. Halil Thaqi;
 - 1.5. Besim Shyti;
 - 1.6. Safet Sadiku.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh. A. Gjakovë emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Mirlinda Kusari, kryesuese;
 - 1.2. Fuat Pallaska;
 - 1.3. Muharrem Jupa;
 - 1.4. Rexhë Ukaj;
 - 1.5. Lulzim Shala;
 - 1.6. Kujtim Dula.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 14/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Anullohet Vendimi i Qeverisë Nr. 12/106, i datës 11 qershor 2019.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vazhdimin e afatit kohor për procesin e legalizimit të armëve.
2. Afati kohor nga pika 1. e këtij vendimi vazhdohet për periudhën tre (3) mujore dhe fillon nga data 18 qershor 2019 deri me 17 shtator 2019.
3. Autorizohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 17/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 8, 10, 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vlerësimi i ndikimit socio ekonomik për pronat e paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të miratuara për shpronësim sipas Vendimeve Përfundimtare Nr. 06/98 datë 18.04.2019, Nr. 07/95 datë 26.03.2019, Nr. 05/73 datë 30.10.2018 dhe Nr. 06/73 datë 30.10.2018 të cilat preken nga realizimi i Projekteve të infrastrukturës:
 - Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25.2 Hyrja në Gjilan, me gjatësi L=3km, ZK Gjilan dhe Livoq i Epërm, Komuna Gjilan dhe ZK Koretishtë, Komuna Novobërdë,
 - Zgjerimi i Rrugës Nacionale N2 Segmenti "Hyrja në Qytetin e Ferizajt", Zonat Kadastrale: Perlez i Jerlive, Muhoc, Talinoc i Jerlive, Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj dhe Fshati i Vjetër, Komuna Ferizaj,
 - Zgjerimi i Rrugës Nacionale R 107, Segmenti "Hyrja në Qytetin e Prizrenit" Zonat Kadastrale: Dushanovë, Atmaxhe dhe Landovicë, Komuna Prizren,
 - Rehabilitimi i Rrugës Nacionale N25.3 Segmenti "Kllokot Gjilan" me gjatësi L=14.50 km, Zonat Kadastrale: Kllokot, Komuna Kllokot, Budrigë e Epërme dhe Radivojçë, Komuna Viti, Partesh dhe Budrigë e Poshtme, Komuna Partesh dhe Zonat Kadastrale Gjilan, Livoq i Ulët dhe Cërnice të Komunës së Gjilanit, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokollit 1233/19 datë 07.03.2019.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Mjetet financiare për pagesën e vlerësimit të ndikimi socio-ekonomik do të sigurohen dhe do të ndahen nga Ministria e Financave në Kodin 60500 Zyra e Shpronësimit pas miratimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Ministria e Infrastrukturës t' i ofroj Departamentit të Shpronësimit të gjitha dokumentet juridike (leje për shfrytëzim, pagesa etj., të nxjerra gjatë inspektimeve për respektim të brezit rrugor përgjatë këtyre rrugëve për pronat e pronarëve dhe zotërueseve të interesit konform Ligjit për Rrugët të Kosovës, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Konform dokumentacionit nga pika 2 dhe 5 e këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë shumën e kompensimit të vlerësimit socio-ekonomik.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 18/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, nr. prot. 1149/19 datë 17.06.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga themelimi i "Zonës Ekonomike" në Komunën e Malishevës, Zonat Kadastrale Banjë, Bellanicë dhe Senik të Komunës së Malishevës, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 1149 datë 15.03.2019.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarëve për pagesë, Departamenti i Shpronësimit do të bëjë pagesën e pronave në koordinim me Ministrinë e Financave e cila do të ndajë mjete shtesë në Kodin 60500 (Programi i shpronësimit).
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 19/107
Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Masat e Sigurisë së Rrjeteve të Sistemeve të Informacionit.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë